



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800561/4

Tiranë ___/___/2018

Lënda: Rekomandim për përfshirjen e shtetasit S. H., në skemën e Ndhmës Ekonomike.

Drejtuar: Z. Bashkim Shehu
Kryetar i Bashkisë

Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror

Për dijeni: Z. S.H.,
Fshati Shishtavec

KUKËS

Institucioni i Avokatit të Popullit, mbështetur në pikën 1, të nenit 60 të Kushtetutës, si dhe ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, mori për shqyrtim ankesën e shtetasës S.H.,.

Në shkresën zyrtare me nr. K5/S4-2 prot., datë 11.4.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Kukës, kërkoi informacion lidhur me shqyrtimin e problemit të ngritur dhe informimin e qytetarit në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Në shkresën zyrtare me Nr144/1/1Prot. datë 23.4.2018, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Kukës, informon institucionin e Avokatit të Popullit si më poshtë vijon:

- Familja e shtetasit Seman Suri Hoxha është trajtuar në skemën e vjetër të ndihmës ekonomike deri në dhjetor 2017.
- Për periudhën janar-mars 2018, familja e shtetasit Seman Suri Hoxha nuk ka rezultuar përfituese nga sistemi i pikëzimit të skemës së re të ndihmës ekonomike.
- Në mbështetje të pikës 1, të udhëzimit nr.5, datë 17.2.2017 i Ministrisë të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë "Mbi zbatimin e vendimit nr.955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar, Këshilli Bashkiakë ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për

familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, duke përdorur deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, familja e shtetasit Hoxha është trajtuar në skemën e ndihmës ekonomike, me masën prej 2700 lekë në muaj për periudhën shkurt-mars 2018.

Gjithashtu, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Kukës, sqaron se ky vendim u morë pas vlerësimit social ekonomik të realizuar në bashkëpunim me Bashkinë Kukës.

Pra, familja Hoxha nisur nga kushtet social-ekonomike, të vlerësuara dhe statusit të tij, kryefamiljar me një fëmijë plotëson kriteret për t'u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike.

Nga vlerësimi i informacionit të lartëpërmendur kjo familje nuk e ka përfitur masën e përfitimit nga skema e ndihmës ekonomike në muajin janar 2018, për shkak të mosveprimeve të kryera nga institucionet përgjegjëse, duke shkelur plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale të shtetasit Hoxha dhe fëmijës së tij si rezultat i aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

Po ashtu në mbështetje të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën, ku aftësitë e prindërve që kujdesen për mirërritjen e fëmijës t’iu përgjigjen nevojave të fëmijës, ku parim duhet të aplikohet gjerësisht në mënyrën e duhur në procedurat ligjore, administrative dhe gjyqësore.

Për sa më sipër, institucioni i Avokati të Popullit konkludoi se, marrja e vendimit për përfshirjen e familjes Hoxha në skemën e ndihmës ekonomike është marrë vetëm për periudhën shkurt-mars 2018 dhe, në mbështetje të legjislacionit të lartëpërmendur nuk është sqaruar vazhdimësia e mbështetjes për këtë familje për të mundësuar krijimin e mundësive për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

Ndaj, referuar parashtrimin të mësipërm, për çështjen në fjalë,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për përfshirjen e familjes Hoxha, në skemën e ndihmës ekonomike për periudhën kohore në vazhdimësi dhe fuqizimin e familjes, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve sociale, për të garantuar zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social të fëmijës së tij, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për ta.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit.

Për sa më sipër, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe në vijim të na informoni për qëndrimin tuaj ndaj tij.

Duke Ju falënderuar dhe në vijim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, shpresoj dhe besoj në gjykimin Tuaj për vlerësimin e këtij rekomandimi.

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA